

VENDIM
Nr. 47, datë 13.6.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe Rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër, për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Peshkopi (Dibër), me NUIS J66702738B, është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 11, datë 21.5.2014, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Peshkopi”, me vlefshmëri për kategoritë A deri në datën 12.11.2016, ndërsa për kategorinë C deri më 20.5.2018.

- Shoqëria, me shkresën nr. 78 prot., datë 15.1.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së, për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës. Me shkresën nr. 294 prot., datë 31.5.2018, janë bërë plotësimet përkatëse në dosjen e aplikimit pas mangësive që kishte.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Dibër plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekstraktin e QKB-së mbi emrin e subjektit;
- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër, me:

Drejtues ligjor Arif Shini

Drejtuesit teknik Dritan Nuzi

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Dibër, si më poshtë:

- a) Njësitë administrative: Peshkopi;
- b) Qendër Tomin;
- c) Kastriot;
- d) Luzni;
- e) Sllovë;
- f) Kala e Dodës;
- g) Fushë-Çidhën.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani